



PROGRAMI I LEHTËSIRAVE

Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2023 për Përcaktimin e Procedurës dhe Kriteve për Lirim ose Zvogëlim të Gjobës. Autoriteti do të lirojë nga gjoja, pjesëmarrësin e marrëveshjes së ndaluar që i pari njofton Autoritetin dhe i ofron prova që mundësojnë konstatimin e shkeljes së ligjit, e cila i plotëson kriteret e përgjithshme për lirim ose zvogëlim e gjobës, lirimi nga gjoja nuk zbatohet për ndërmarrjen që ka qenë nismëtare ose nxitëse e marrëveshjes së ndaluar.

Qëllimi i lirimit ose zvogëlimit të gjobës, është inkurajimi i ndërmarrjeve pjesëmarrëse në kartel që të zbulojnë ekzistencën e karteleve, t'i japin fund pjesëmarrjes së tyre në kartel dhe të bashkëpunojnë me Autoritetin kur hetohet karteli.

Çdo ndërmarrje, e cila dëshiron të shmangë plotësisht ose pjesërisht sanksionin duke bërë një aplikim për lehtësim, duhet të bashkëpunojë plotësisht me Autoritetin e Konkurrencës deri në përfundimin e procedimit (detyrimi për bashkëpunim).

Ndërmarrja që dëshiron të përfitojë nga përjashtimi i gjobës, duhet të parashtrojë kërkesën sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2023, ose mund të aplikojë fillimisht për një shënues, i cili në rast të miratimit nga Autoriteti për periudhën kohore të specifikuar nga Autoriteti, i siguron ndërmarrjes vendin në radhën për përjashtim nga gjoja.

Ndërmarrja e cila e njofton Autoritetin, ofron provat dhe jepë deklaratë në Autoritet, e cila përmban:

1. Përshkrimin e hollësishëm të kartelit, qëllimet, aktivitetet dhe veprimet, mallrat dhe/ose shërbimet e përfshira në kartel, vlerësimin e kryer të pjesës së tregut të pjesëmarrësve në kartel, zonën gjeografike në të cilën ka efekt karteli, kohëzgjatjen e kartelit, datat, vendet, përmbajtjen dhe personat e përfshirë në realizimin e kartelit, si dhe të gjitha të dhënat e nevojshme, lidhur me provat e paraqitura bashkë me kërkesën,
2. Emrin dhe adresën e pronarit të ndërmarrjes e cila ka paraqitur kërkesën, si dhe emrat dhe adresat e të gjitha ndërmarrjeve tjera që marrin ose kanë marrë pjesë në kartel,
3. Emrat, pozitat, vendndodhjet e zyrave, si dhe kur është e nevojshme, adresat e shtëpive të të gjithë individëve të cilët, sipas njohurive të ndërmarrjes që parashtrohet kërkesën, janë ose kanë qenë të përfshirë në kartel, duke përfshirë ata individë që kanë qenë të implikuar në emër të ndërmarrjes që paraqet kërkesën,
4. Informacionin nëse kërkesa është parashtuar apo do të parashtrohet pranë ndonjërit prej Autoriteteve të shteteve anëtare të BE-së apo Autoriteteve të shteteve tjera, respektivisht nëse në ndonjë mënyrë u është drejtuar ose ka ndërmend të ju drejtohet këtyre organeve në lidhje me kartelin e raportuar.